

ALEKS ÇAÇI

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8SH-1

C 13

**ERA
E
POPULLIT**

**vjersha
dhe poema**

8 SH-1

c 13

ALEKS ÇAÇI

ERA E POPULLIT

Vjersha
dhe poema

11740



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

DUART E MINATORIT

Kallot kanë mbirë në duart e tij,
djersa derdhet dhe ai s'ndalet,
të tjerët e shikojnë, ai s'flet,
dheu tundet kur ai hyn brënda,
kërkon, thellësitë dalin në dritë,
dheun nxjerr, gjith jeta qesh.
Duart e minatorit t'i puthim,
në zemrat tona t'i fusim.

VRESHTA

Vreshta, me radhë, faqeve të maleve.
Të parët e mi pinë verë;
u dehën disa herë.
Rrënjët janë të thella, janë mpleksur,
tregojnë vitet që shkuan.
Shtëpia ime është ngritur mbi këto rrënjë,
vjen erë verë.

Tarraca të reja, vreshta, vreshta...
Sy të kaltërt si deti,
faqe të kuqe si vera,
krahë të fortë si shkëmbinjtë,
sy të mprehtë si të shqiponjave,
zëra të bukura si të thëllëzave
dhe maja të larta me dëborë
dhe një diell që hyn thellë në dhé
dhe lart një qiell i kaltër pa re.

NËNA MË SHIKONTE NË SY

Në një shtëpi të vogël na rrethuan.
Nëna më shikonte në sy,
unë e dija ç'do të thoshë.
Në ato çaste ajo mendonte për mua,
kujtonte kohën kur më lindi
rrëzë një mali,
ditën kur i kërkova bukë
dhe nuk kishte të më jipte,
kur u sëmura rëndë dhe ndënji
gjithë natën pranë meje,
më jipte sytë e saj që të shikoja,
zembrën e saj që të mirrja frymë,
kujtonte këmbët e mia të zbathura
plot gjemba, që më kullonin gjak,
fjalët që i thashë një ditë
se do t'i blija një fustan të ri
kur të rritesha...
Të gjitha i kujtonte.

Dhe, në ato çaste,
 nëna ime,
 shtrëngoi grushtin nga zemërimi,
 dhe ne dolëm nga rrethimi.

NE NA ME SHIKONTE NE SY

Me një shprehje të vogël në rrethim.
 Nëna me shikonte në sy,
 unë e dija që do të thoshë.
 Në ato çaste ajo mendonte për mua,
 kështuante koha kur më lindi
 rreth një mulli.
 diçka kur i kërkonte bukë,
 dhe ajo kishte të njëjtë,
 kur u sëmura rëndë dhe ndënjë,
 rrethitë pamë pranë meje,
 në një shtëpi e saj që të shikojë,
 xhaminë e saj që të mirënjohë,
 kështuante kështu e mja të vërtetë,
 plot gjendje, që në kulmbin e saj,
 lulet që i thashë një ditë
 e jo, diçka në lulet të
 kur të rrethim...
 Të gjithë i kështuante

NËNA IME SHIKONTE NJË LIBËR

Nëna ime shikonte një libër
dhe para syve i rrinte një mjegull.
Libri vërtitej, afrohej, —
nëna ime shikonte një libër.
Era frynte, shiu binte,
nëna ime flinte,
shikonte një libër dhe më thosh,
unë e di ç'thua, janë fjalët e mia,
janë fjalët e tua,
Lindi një ditë me mjegull, pa sy,
jetoj në mjegull,
nëna ime,
po vdiq pa rrënkime.

MËNGJESIN E MBUSHE

Minkës

Mëngjesin e mbushë
me zërin tënd të ëmbël.
Ish zëri yt i parë që dëgjova.
Gjaku im ecën në gjakun tënd.
Ti qesh
se unë kur linda nuk qesha.
Qesha vetëm një herë,
kur mendova se do të qeshësh ti
përherë.

Kur flet shtëpia mbushet me aromë.
Fjalët që thotë nxjerrin këngë.
Zemrën e ka të bardhë borë,
faqet i ka të kuqe flakë,

me rrezet lot çdo mëngjes,
ëndrra të bukura mendon,
me krahë në qiell fluturon.
Sa do të doja, gjithnjë
që ta shikoja të gëzuar,
ta mbaj në duar si xhuvele
pemërenduar.

UNË LINDA QË TË JETOJ KËTU

Unë linda që të jetoj këtu,
në mes shkrepëtimave që zbresin nga mali,
të dëgjoj gurgullimën e burimeve,
fëshfërimën e fletëve të rrapit në mes të fshatit,
të flas me nënën time
dhe të më thotë
fjalët më të mira që dëgjova në botë.
Unë linda një ditë të largët,
kur nëna ime s'kish ngrënë bukë atë ditë,
unë atë pashë të parën
dhe sytë e saj, si atëherë, i shoh edhe tani.
Ishin sy të vrenjtur, të mavijosur,
sy të thellë, po sy të tillë
nuk pashë më.
Këtu linda dhe këtu do të mbetem,
me të parët e mi pranë.
E punoni mirë këtë tokë, o vëllezër,
kujdes, mbillni misër e grurë shumë
që njerëzit të kenë të hanë.